

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**KEVINVEST SHPK**

Sot me date 30 / 01 / 2023, ne themeluesit:

1. **Kevin Gjergji** i biri i Arbenit, lindur ne Greqi më 09.08.2001 e banues në Lezhë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 033609723 dhe me nr. NID: K10809042J dhe
2. **Linknejda Gjergji** e bija e Bardhytit, e lindur në Tiranë më 06.05.1976 e banuese ne Tirane, mbajtëse i kartës së identitetit me nr. 034316916 dhe me nr. NID: H65506065M

shprehin vullnetin per krijimin e Shoqerise **KEVINVEST SHPK** sipas kushteve te meposhteme:

**Neni 1**

**THEMELIMI DHE FORMA LIGJORE “ SHPK”**

- 1.1.Emri i Shoqërisë është KEVINVEST SHPK.
- 1.2. Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjesi te kufizuar.
- 1.3.Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

**Neni 2**

**ORTAKET THEMELUES**

Ortaket Themelues te Shoqerise jane: **Z. Kevin Gjergji** dhe **Zj. Linknejda Gjergji**.

**Neni 3**

**OBJEKTI**

Objekti i veprimtarise te shoqerise KEVINVEST SHPK eshte: *“Shërbime të çdo lloji, përfshirë por pa u kufizuar me shërbimet financiare në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe licensat përkaëse, shërbimet turistike dhe/apo të konsulences, shërbimet e delivery, shërbimet e shit - blerjes së mallrave dhe/ose shërbime në të gjitha format dhe menyrat e ligjshme me internet online, rimbushje elektronike etj. Transferim te parave ne emer dhe per llogarite subjektit financiar jo banke AK-Invest sh.a”*.

*Kevin Gjergji*  


*Linknejda Gjergji*  


#### **Neni 4**

#### **SELIA**

Selia e shoqërisë tregtare **KEVINVEST SHPK** do të jete ne adresen: **Lezhë, Lagja Beslidhja, Rruga Franz Josef Strauss, Pallati Uldedaj**, regjistruar ne ZVRPP Lezhë, Zona Kadastrale nr.8632, me nr. pasurie 4/400-N10.

Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

#### **Neni 5**

#### **KOHEZGJATJA**

Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë kohore të pacaktuar.

#### **Neni 6**

#### **KAPITALI I SHOQËRISE**

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare **KEVINVEST SHPK** është **100.000 Leke** (një qind mijë). Kapitali themeltar është i ndarë në 2 kuota dhe është e ndarë midis ortakeve si mëposhte :

- 1- Z. Kevin Gjergji, zoteruesi i 1 kuote që përfaqëson 15% të kapitalit, në vlerë 15.000 Leke.
- 2- Zj. Linknejda Gjergji, zoterues i një kuote që përfaqëson 85% të kapitalit, në vlerë 85.000 Leke.

Kuotat janë nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë. Cdo kuote përfaqëson të drejtën e një vote.

Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

#### **Neni 7**

#### **ORTAKET**

Ortakët ushtrojnë kompetencat që ligji i jep Asamblese së Ortakeve.



**Neni 8**  
**ADMINISTRATORI**

Administrator i Shoqërisë emërohet z. Kevin Gjergji, atësia Arben shtetas shqiptar, identifikuar me anë të letërnjoftimit me numër 033609723 me numër personal K10809042J i datëlindes 09.08.2001 lindur në Greqi dhe banues në Lezhe, me afat emërimi 3 vjekar.

**NENI 9**  
**BAZA LIGJORE**


Shoqëria do të ushrojë aktivitetin në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

**Ortaktët Themelues**  
**të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**KEVINVEST shpk**

**Z. Kevin Gjergji**

*Kevin Gjergji*  


**Zj. Linknejda Gjergji**

*Linknejda Gjergji*  


**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“KEVINVEST” sh.p.k**

Sot me datë 30.01.2023, ne themeluesit kemi krijuar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “KEVINVEST” shpk.

Themeluesit e shoqërisë janë:

1. **Kevin Gjergji** i biri i Arbenit, lindur ne Greqi më 09.08.2001 e banues në Lezhë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 033609723 dhe me nr. NID: K10809042J dhe
2. **Linknejda Gjergji** e bija e Bardhylit, e lindur në Tiranë më 06.05.1976 e banuese ne Tirane, mbajtëse i kartës së identitetit me nr. 034316916 dhe me nr. NID: H65506065M


**Kreu I**  
**DISPOZITA TE PERGJITHESHME**


**Neni 1**  
**Forma Ligjore dhe Emri i Shoqerise**

- 1.1. KEVINVEST SHPK eshte themeluar bazuar ne ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, si dhe ne Aktin e Themelimit te Shoqerise nenshkruar nga Ortaket Themelues.
- 1.2. KEVINVEST SHPK eshte themeluar dhe funksionon si shoqeri tregtare "me pergjegjesi te kufizuar" (sh.p.k). Nga ketu e me poshte ne kete Statut Shoqeria **KEVINVEST SHPK** do referohet shkurtimisht Shoqeria.
- 1.3. Shoqeria fiton personalitetin juridik si dhe te drejten per te kryer veprime dhe te marre persiper te drejta dhe detyrime gjate aktivitetit te saj te perditshem.
- 1.4. Shoqeria do të kryeje aktivitetin e saj bazuar ne Legjislacionin Shqiptar, Statutin dhe Aktin e Themelimit.

**Neni 2**  
**Ortaket e Shoqerise**

- 2.1. Shoqeria eshte themeluar nga Ortaket: **Z. Kevin Gjergji** dhe **Zj. Linknejda Gjergji**.
- 2.2. Ortaket, pergjigjen per humbjet e shoqerise deri ne vleren e kapitalit themeltar te saj.

*Kevin Gjergji*  


*Linknejda Gjergji*  


**Neni 3**  
**Kohezgjatja**

3.1. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, sipas objektit, per nje periudhe te pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar.

**Neni 4**  
**Selia**

4.1. Selia e Shoqerise KEVINVEST SHPK eshte ne adresen: **Lezhë, Lagja Beslidhja, Rruga Franz Josef Strauss, Pallati Uldedaj**, regjistruar ne ZVRPP Lezhë, Zona Kadastrale nr.8632, me nr. pasurie 4/400-N10.

4.2. Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5**  
**Objekti i Aktivitetit**

Objekti i veprimtarise te shoqerise KEVINVEST SHPK eshte: *“Shërbime të çdo lloji, përfshire por pa u kufizuar me shërbimet financiare në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe licencat përkaëse, shërbimet turistike dhe/apo të konsulences, shërbimet e delivery, shërbimet e shit - blerjes së mallrave dhe/ose shërbime në të gjitha format dhe menyrat e ligjshme me internet online, rimbushje elektronike etj. Transferim te parave ne emer dhe per llogarite subjektit financiar jo banke AK-Invest sh.a”*.

**Kreu II**  
**KAPITALI DHE KUOTAT**

**Neni 6**  
**Kapitali themeltar**

6.1. Kapitali themeltar i shoqerise tregtare KEVINVEST SHPK eshte **100.000** (njeqind mije) Leke.

6.2. Kapitali themeltar eshte i ndare ne 2 (dy) kuota.

6.4. Ortaket jane zoterues te kuotave si me poshte :

- 1- Z. Kevin Gjergji, zotërues i 1 kuote, që përfaqëson 15% te kapitalit, ne vlere 15.000 Leke
- 2- Zj. Linknejda Gjergji, zotërues i 1 kuote, që përfaqëson 85% te kapitalit, ne vlere 85.000 Leke



6.5. Kuotat jane nominative dhe nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere.

6.6. Cdo kuote perfaqeson te drejten e nje vote.

## **Neni 7**

### **Regjistri i kuotave te kapitalit themeltar**

7.1. Kuotat dhe zoteruesi i tyre, si dhe te dhena te tjera qe lidhen me kuotat e kapitalit themeltar, regjistrohen ne nje regjister te posacem.

7.2. Forma dhe modalitet e tjera te regjistrimit miratohen me vendim te Asamblese se Ortakeve.

7.3. Ne rast te zoterimit te kuotave te shoqerise nga me shume se nje ortak forma dhe modalitet e tjera te ketij regjistri miratohen me vendim te ortakeve qe zoterojne me shume se 3/4 e kuotave.

## **Neni 8**

### **Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me vullnet te ortakut**

8.1. Ortaket mundet te transferoje lirisht tek te tretet, pjeserisht ose teresisht, pjeset e kapitalit themeltar te shoqerise.

8.2. Transferimi i ketyre pjeseve brenda shoqerise mundet te behet lirisht ndersa transferimi tek personat e trete mund te behet vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

## **Neni 9**

### **Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi**

9.1. Pjeset e kapitalit themeltar mundet te transferohen lirisht dhe pa asnje klauzole kufizuese ne kete Statut, nepermjet trashegimise, si dhe midis bashkeshorteve ne rast ndarje pasurore.

9.2. Pjeset e kapitalit themeltar mundet te transferohen lirisht dhe pa asnje klauzole kufizuese ne kete Statut, midis bashkeshorteve si dhe midis prindit dhe femijes ose anasjelltas.

## **Neni 10**

### **Akti i transferimit pjeseve te kapitalit themeltar**

10.1. Ne cdo rast transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me vullnetin e ortakut duhet te vertetohet nepermjet nje akti noterial.

10.2. Trasferimet e pjeseve te kapitalit themeltar pasqyrohen ne regjistrin e posacem te miratuar sipas nenit 8 te ketij Statuti. Mos pasqyrimi i transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar ne kete regjister, nuk e ben te pavlefshem aktin e transferimit.

10.3. Akti i transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar duhet te depozitohet ne Regjistrin Tregtar jo me vone se nje muaj nga data e regjistrimit te ketij akti ne zyren noteriale perkatese. 10.4. Kerkesa per depozitim e aktit te shitjes se pjeseve te kapitalit themeltar mundet te behet nga shitesi ose nga bleresi, ose prej perfaqesuesve te tyre te autorizuar.

## **Neni 11**

### **Zmadhimet e kapitalit me ane te kontributeve ne para**

- 11.1. Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet me kontribute ne para me vendim te ortakeve.
- 11.2. Zmadhimi sipas pikes 1 te ketij neni behet me shlyerjen teresisht te vleres se shtuar prej Ortakeve.
- 11.3. Shlyerja e fondeve mund te vertetohet nga nje zyre noteriale ose nepermjet nje konferme bankare.
- 11.4 Ne rast se zmadhimi i kapitalit nuk kryhet brenda 6 muajve nga data e depozimitit te fondeve, Ortakut perkates i lind e drejta te terheqe fondet e depozituara.

## **Neni 12**

### **Zmadhimi i kapitalit me ane te kontributeve ne natyre**

- 12.1. Zmadhimi i kapitalit themeltar nepermjet kontributeve ne natyre behet me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- 12.2. Vlera e kontributit ne natyre si shtese e kapitalit themeltar percaktohet nga nje ekspert i cili emerohet nga Asambleja e Ortakeve.
- 12.3. Te dhenat mbi kontributin ne natyre te shtuar si pjese e kapitalit themeltar pasqyrohen ne Statut dhe regjistrohen ne Regjistrin Tregtar. Ne rast te kundert zmadhimi konsiderohet i pa bere.

## **Kreu III**

### **ORGANET DREJTUESE DHE TE ADMINISTRIMIT TE SHOQERISE**

## **Neni 13**

### **Organet drejtuese**

Organet drejtuese te shoqerise KEVINVEST SHPK jane:

- a. Asambleja e Ortakeve
- b. Administratori

## **Neni 14**

### **Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve**

- 14.1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë.
- 14.2. Asambleja e Ortakeve ka keto kompetenca:
- a. ndryshimet ne dispozitat e statutit,
  - b. caktimi dhe shkarkimi i administratorit;
  - c. caktimi dhe shkarkimi i ekspertit/eksperteve kontabel si dhe likuidatorit/likuidatoreve;
  - d. miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit;

- e. miratimi i raportit vjetor;
- f. shperndarja e dividendeve;
- g. ndryshimi i kapitalit themeltar;
- h. transferimi i kuotave te kapitalit themeltar tek palet e treta;
- i. likuidimi dhe/ose shnderrimi i shoqerise. ne nje forme tjeter
- j. të vendosë për cdo ceshtje tjetër që i takon për zgjidhje Asamblesë së Ortakëve me ligj dhe/ose sipas këtij statuti.

## **Neni 15**

### **Administrimi i Shoqërisë dhe kompetencat e administratorit**

15.1. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a. të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b. të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c. të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- e. Miraton pagat mujore te gjitha kategorive te punemarresve, ne përputhje me tabelen e pagave te miratuar.

15.2. Mandati i Administratorit të shoqërisë është 3 (tre vjet) me të drejtë rizgjedhjeje.

15.3. Administrator i parë i shoqërisë është Z. Kevin Gjergji, i datëlindjes 09.08.2001, lindur në Greqi dhe banues në Lezhe, identifikuar me Letërnjoftim me Nr. 033609723 dhe me Nr. Personal K10809042J.


## **Neni 16**

### **Dispozita përfundimtare**

Ky statut u hartua në 3 kopje origjinale me përmbajtje dhe vlerë të njëjte juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi u miratua nga ortakët e shoqërisë “KEVINVEST” shpk u nënshkrua në të gjitha kopjet.

## **ORTAKET E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “KEVINVEST” shpk**

**Z. Kevin Gjergji**



**Zj. Linknejda GJERGJI**

